Dt. 26.04.2024

Proces-Verbal i mbajtur sot më datë 26.04.2024, ora 13:00 min, në sallën e mbledhjeve, pranë Bashkisë Cërrik. Në mbledhje marrin pjesë dy përfaqësues të dializës, kryetari i Bashkisë Z. Andis Salla dhe Këshilltarët:

| | |
|---|---|
| 1- Besnik Binjaku | 11- Asgeri Dibrraku |
| 2- Erona Gjini | 12- Zegine Dhepa |
| 3- Jetmir Laroshi | 13- Qemil Boja |
| 4- Zamira Fahriu | 14- Madire Asllani |
| 5- Adriatik Belshi | 15- Elton Kumria |
| 6- Erinda Vishkulli | 16- ~~El~~ Flutura Hoxholli |
| 7- Adi Çepa | 17- Shyqyri Dhika |
| 8- Burbuqe Qafa | 18- Mondi Ploka |
| 9- Elton Ibro | 19- Shyqyri Komomi |
| 10- Pranvera Liçi | 20- Anisa Taçi |
| | 21- Gazmira Frakulli |

Mbledhja kryesohet nga kryetari i Këshillit Bashkiak i cili konstatoi se në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e Këshilltarëve dhe Këshilli i plotë ligjshëm mund të vendos.

Kryesuesi: Para se të vazhdojmë me rendin e ditës, do të doja të dëgjonim kërkesën e dy qytetarëve Z. Bledar Mehalla dhe Z. Gazmir Beqiri. Dy zotërinjtë kanë një kërkesë për ti siguruar transportin 20 personave me dializë në Bashkinë Cërrik. Zotërinjtë kërkojnë ti vihet në dispozicion Ambulanca.

Z. Adriatik Belshi :- Për sa i përket Ambulancës është e pamundur, ambulanca është për urgjencat dhe duhet të jetë në gadishmëri.

Znj. Gazmira Frakulli :- Të nxjerrë një lishencë Bashkia. Unë kam diskutuar me disa pacient dhe ata përveç lekut që i ofron shteti janë të gatshëm të fusin dhe lekë shtesë vetë të vihet në dispozicion një furgon 3-oraresh. Oraret do ti rregullojnë vetë.

Besnik Binjaku :- Baza ligjore se lejonë.

Andis Salla :- Ne do ju japim një zgjidhje me kapacitet tona dhe pse kjo s'është kompetencë e jona.

Z. Jetmir Laroshi :- Vazhdojmë me rendin e ditës: Për këtë mbledhje paraqitet ky Rend-Dite:

1- Pr/Vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Bllok-Ndihmën 6%".

2- Pr/Vendim: "Për dhënien e ndihmës Ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për periudhën 1-29.02.2024".

3- Pr/Vendim: "Për një ndryshim vendimi Nr. 05, datë 25.01.2024 "Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil."

Jashtë Rendit të ditës

1- Pr/Vendim: "Për mbështetjen me bazë materiale të institucionit të ekzekutimit të vendimeve Penale Peqin."

2- Pr/Vendim: "Për shfuqizimin të afatit të vendimit Nr. 106, datë 20.11.2020 "Për miratim të afatit të Administratorit të klubit të Futbollit Turbina, Cërrik "SHPK"."

3- Pr/Vendim: "Për miratimin e përditësimit të pjesshëm të listës së pronave shtetërore transferuar në pronësi të Bashkisë Cërrik."

Kryesuesi :- Kush është dakortë me rendin

e ditës dhe ndryshimet në të?
Miratohet Rendi i ditës me: 21 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Apsten.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës
Pika 1
Znj. Ornela Mehmeti, përgjegjëse e sektorit Social i propozonë Drejtorisë Rajonale të shërbimit Social, të përfitojnë ndihmë financiare/Ekonomike për muajin Mars 2024, me 6% e fondit të Blok-Ndihmës 35 familje me një fond prej 137.045 lekë. Paga të kryhet sipas listës emërore bashkëlidhur projektit.
Pyetje dhe diskutime? Ska
Miratohet me: 21 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim

Pika 2
Znj. Ornela Mehmeti, i propozon këshillit Bashkiak të miratojnë projekt-vendimin ku të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e bashkisë Cërrik, për muajin Mars 2024, 37 familje me një fond prej 186.810 lekë. Ndarja sipas Njësive Administrative.
Pyetje dhe diskutime? Ska
Miratohet me: 15 vota Pro
6 vota kundër
0 vota Apstenim

Pika 3
Znj. Xheni Sallja, Juriste pranë Bashkisë i propozon këshillit Bashkiak të miratojnë një ndryshim në Vendimin Nr. 05 datë 25.01.2024 "Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil". Znj. Sallje shtoi se ndryshimet e niveleve të vendeve vakante për efekt të përllogaritjeve të vendeve në shërbimin civil dhe për caktim të vendeve vakante për aplikim nga jashtë SHC. Numri i vendeve vakante të planifikuara për reduktim, pjesë e administratës së Bashkisë Cërrik ishte: Total 22 dhe caktë 25.
Pyetje dhe diskutime? Ska
Miratohet me 21 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim

Pika 4
Z. Hekuran Kumrija, Drejtor i financës i propozon këshillit të miratojnë: 1- Pranimin e kërkesës të Institucionit të ekzekutimit të vendimeve Penale "Peqin", për mbështetje me bazë materiale."
2- Vënien në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë të një fondi prej 100000 (Njëqindmijë) lekë për blerjen e bazës materiale të nevojshme.
3- Trasferimin e këtyre materialeve pa pagesë Institucionit të ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin.
Pyetje dhe diskutime:
Znj. Gazmira Frakulli: - Këto materiale Sportive do ishte më mirë të shkonin për shkolla dhe jo për burgje. Ka shkolla plot që kanë nevojë për rrjeta etj.
Miratohet me: 21 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim

Pika 5
Z. Hekuran Kumria, i propozon këshillit Bashkiak

të miratojnë zgjatjen e afatit të kontratës për një periudhë 3 mujore për Administratorin e klubit të Futbollit "Turbina" me nr. nipti K72804202 B me Adresë Cërrik, Elbasan, z. Genhjan Gjoka i cili zotëron 60% të aksioneve të këtij klubi. Z. Hekuran shpjegon se: Asetet do kalojnë në Ankand. Ne na duhet që ta kalojmë në këshill për 3 muaj për mos ta djegur. Futbollin ne duam ta çojmë në rrugë. Ne duhet ta shesim 40%.

Pyetje dhe diskutime ? S'ka

Miratohet me : 21 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Abstenim.

Pika 6

Znj. Suzana Frokulli :- Punonjëse pranë Urbanistikës i propozon këshillit Bashkiak Cërrik të miratojnë listën e pjesshme të pronave shtetërore të përditësuara, transferuar në pronsi të Bashkisë Cërrik. Lista e pronave transferuar në pronsi apo përdorim të Bashkisë Cërrik është miratuar me VKM nr. 573, datë 28.05.2009.

Pyetje diskutime ? S'ka

Miratohet me : 21 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Abstenim.

Jashtë Rendit.

Z. Jetmir Laroshi :- kemi dhe një kërkesë për Këshillin Bashkiak nga një Qytetar z. Agim Boka. Duke qenë se kërkesa është voluminoze kërkojmë që mbledhjen e radhës qytetari të jetë vet prezent për të prezantuar kërkesën e tij.

Duke ju falenderuar për pjesmarrjen mbledhjen e deklaroj të përfunduar. Në këtë mbledhje u miratuan 6 (gjashtë) vendime. Mbledhja përfundoi në orën 15:15 min.

Sekretare e këshillit
Edije Asllani

Jetmir Laroshi

Bexhet Zijaku

Burbuqe Gjafa

Pranvera Liçi

Eltion Jzko

Shyqyri Kamamy

Qamil Boja

Fleture Hoxholli

Shyqyri Mo[illegible]

Kadire Asllani

Zegine Dhepo

Evona Gjini